



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2024:034874  
Datë: 30.03.2024  
Numri i dokumentit: 05528938

KPPP.nr.210/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbareme të kreditorit Inspektorati i Punës në Kosovë, kundër debitorit Vatan Med, Baris Ozkan, Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhrin përmbareme P.nr.343/2023 të datës 13.12.2023, të Përmbaremit Privat Emine Sherifi-Lubeniqi me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 29.03.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit Vatan Med, Baris Ozkan, Prishtinë, i paraqitur kundër Urdhrin Përmbareme P.nr.343/2023 të datës 13.12.2023, i lejuar nga Përmbaremi Privat Emine Sherifi-Lubeniqi, dhe i njejt Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.

**A r s y e t i m**

Përmbaremi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Inspektorati i Punës në Kosovë, me datë 13.12.2023, ka lëshuar Urdhrin Përmbareme P.nr.343/2023, me të cilin ka lejuar përmbaremin në bazë të dokumentit përmbareme Vendimit të Inspektoratit të Punës Nr.10/NY-16-22 të datës 01.03.2022, me të cilin është urdhëruar debitori që menjëherë pas pranimit të këtij urdhri, në emër të masës ndëshkimore, t'ia bëj pagesën kreditorit shumë në vlerë prej 1,500.00 Euro, si dhe shpenzimet e procedurës përmbareme, nën kërcënim të përmbaremit të dhunshëm.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar urdhrin përmbarrimor, me arsyetimin se nga shikimi i Aktvendimit Nr.10/NY-16-22 i datës 22.03.2022, i bashkëlidhur në propozimin për përmbarrim të kreditorit, shihet se i njëjti i referohet pagesës së gjobës për kundërvajtje. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit ndërsa të anulohet urdhri përmbarrimor P.nr.343/23 i datës 13.12.2023, si dhe të detyrohet kreditori që debitorit t'ia mbulojë të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarrimore konform tarifës së Odës së Avokatëve, shumë prej 156 Euro, në emër të përpilimit të prapësimi nga ana e avokatit.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar, andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbarrues ka lejuar përmbarrimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarrues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarrimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarrues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

Me nenin 22 të LPP-së, në paragrafin 1 nënparagrafin 2 është përcaktuar se dokumente përmbarruese janë *“vendimi përmbarrues i dhënë në procedurë administrative dhe ujdia...”*. Gjithashtu neni 23 paragrafi 2 i LPP-së ka përcaktuar se *“Vendim i organit administrativ, sipas këtij ligji konsiderohet vendimi dhe konkluzioni i dhënë në procedurë administrative nga organi ose shërbimi administrativ apo nga personi juridik i ngarkuar me autorizime publike...”*, kurse neni 24 paragrafi 3 i LPP-së ka paraparë se *“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarrimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”*.

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbarrimor, përkatësisht Vendimin e Inspektoratit të Punës Nr.10/NY-16-22 të datës 01.03.2022, në bazë të së cilit Përmbarruesi Privat ka lejuar përmbarrimin dhe gjeti se i njëjti, konform nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së,

është përcaktuar si dokument përmbarues sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata gjeti se Vendimi Nr.10/NY-16-22 i datës 01.03.2022, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: “*Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit*”, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Vendimi Nr.10/NY-16-22 i datës 01.03.2022, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: “*Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri*”, dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se: “*Vërtetimin për përmbarueshmërinë e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë*”, ngase Vendimi Nr.10/NY-16-22 i datës 01.03.2022, i nxjerrë nga Inspektorati i Punës, është dorëzuar në origjinal, si dhe është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm me datë 14.11.2023, e cila vërtetohet nga vula e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë.

Andaj, meqenëse në këtë çështje përmbarimore gjykata vlerëson përshtatshmërinë e dokumentit përmbarues sipas dispozitave të zbatuara ligjore, nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.210/24, me datë 29.03.2024

Gjyqtari  
Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.